

AKT - MARRËVESHJE

ndërmjet

**Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë
dhe
Bordit të Klubeve Rotariane të Shqiperisë, si dhe Distrikteve
7490 New Jersey – SH.B.A. (marreveshja bashkelidhur e nenshkruar) dhe 2090 Itali.**

- **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë,**
përfaqësuar nga Drejtor i Pergjithshem **Zj. Ogerta Manasterliu (1)**
- **Fakulteti i Mjekësisë,** përfaqësuar nga Dekani **Z. Bajram Hysa (2)**
- **Bordi Klubeve Rotariane te Shqiperise (BKRSht)**
përfaqësuar nga **Kryetari Skender Garori (3),**
- **Komisioni Gift of Life i BKRSht, per Femijet e Semure Kardiak (FSK)**
përfaqësuar nga **Kryetari Z. Enver Doda (4)**

Palet pjesmarrëse (1, 2, 3, 4) në vijim do te quhen “Palë nënshkruese”.

Në mbështetje të Statutit të Qendres Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, me Nr.2360 Prot. Date 25.06.2007 të Ministrisë të Shëndetsisë, Nr. 4564/1 Prot. Datë 26.06 2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkences, lidhet kjo Marreveshje ndërmjet palëve nënshkruese , per t’u ardhur ne ndihme femijeve te semure kardiak, me poshte te emertuar FSK, në kuadrin e vullnetit të mire të mjekësisë shqiptare e Klubeve Rotariane në Shqipëri dhe në vendet e tjera.

Neni 1 Objekti

Kjo Marreveshje do të synojë në këto drejtime:

- Identifikimin e fëmijeve të vegjël të sëmurë kardiak (FSK), kategorizimi i FSK me mundësi trajtimi në Spitalet e Shqipërisë.
- Shqyrtimi i FSK që mund te trajtohen në shtete të tjere nën kujdesin e Klubeve Rotariane e Institucioneve të lidhura me ato, si dhe mundësi i këtij trajtimi.
- Gjetja e partnereve dhe fondeve për të mundësuar ardhjen në Shqipëri te mjekeve të huaj, për trajtimin e rasteve më të veshtrë.
- Nxitja e shkembimit të eksperiences midis mjekëve të Shqipërisë dhe të huaj, në Shqipëri dhe jashtë saj, për përmirësimin e kujdesit mjekësor ndaj FSK.
- Përcaktimi i nevojave më të ngutëshme dhe të papërbalueshme nga buxhetet e institucioneve tona shëndetësore, për aparatura e pajisje të kohës, të nevojshme për trajtimin e FSK dhe tërheqja e donatoreve të gatshëm për sigurimin e tyre.
- Promovim për kontributet e mjekeve shqiptare e të huaj në trajtimin e femijeve të sëmurë kardiak.
- Botime për sensibilizimin e trajtimit të FSK.

Neni 2 Kohezgjatja

Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshje është me afat 1-vjeçar me te drejte rinovimi ne rast se do shikohet e arsyeshme nga palet.

Neni 3

Detyrimet e Bordit të Klubeve Rotariane të Shqipërisë

- Bordi i Klubeve Rotarianë të Shqipërisë (BKRSH), nëpërmjet Komisionit të FSK të ngritur për këtë qëllim, angazhohet me palët për realizimin e kësaj Marrëveshje.
- Bordi i Klubeve Rotariane të Shqipërisë merr përsipër të asistojë pranë Rotary International, The Rotary Foundation (TRF), Distriktit Rotary 7490 te Neë Jersey-USA dhe Distriktit 2090 Itali etj, për realizimin e kësaj Marrëveshje , si Projekt i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm i tij.

Neni 4

Detyrimet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT)

- Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT) sipas mundësive të saj angazhohet për të krijuar kushtet e nevojshme për realizimin e kësaj Marrëveshje, në vecanti në ndihmë të përgatitjes të dokumentacionit të nevojshëm për këtë qëllim.

Neni 5

Detyrimet financiare.

- Palët do të kontribuojnë financiarisht sipas mundësive për realizimin e kësaj Marrëveshje.

Neni 6

Ndryshimet në Marrëveshje

- Cdo përshtatje, shkrirje, modifikim ose ndryshim i tekstit të kësaj Marrëveshje kërkon aprovimin me shkrim të palëve.

Neni 7 Hyrja në fuqi.

- Kjo Marrëveshje hyn në fuqi datën e nënshkrimit të saj.


PALET NE MARREVESHJE

Skender Garori

Kryetari i Bordit të Klubeve
Shqipërisë


Enver Doda

Kryetar i Komisionit të FSK
President i RC Tirana Ëest.



Bajram Hysa

Dekan i Fakultetit
të Mjekësisë



Ogerta Manastirliu

Drejtor i Përgjithshëm
QSUT “Nënë Tereza”

GOVERNATORE, D. 2090 RI

DR. GIOVANNI GARA

10/05/2019

MARREVESHJE

NE NDIHME TE FEMIJEVE TE SEMURE KARDIAK


Mbahet ndermjet paleve nenshkruese, per t'u ardhur ne ndihme femijeve te semure kardiak, ne kuadrin e vullnetit te mire te mjekesise shqiptare e Rotariane ne Shqiperi dhe te huaj.

Kjo Marreveshje do te perqendrohet ne:

- Identifikimin e femijeve te vegjel te semure kardiak.
- Kategorizimi i femijeve me mundesi trajtimi ne Spitalet e Shqiperise.
- Shqyrtimi i rasteve qe mund te trajtohen ne shtete te tjere.
- Mundesi bashkepunimi per te mundesuar ardhjen ne Shqiperi te mjekeve te huaj, per trajtimin e rasteve me te veshtire, qe kerkojne dhe aparatura e pajisje me teknologji te avancuara.
- Shkembim eksperience me mjeke te huaj ne trajtimin e rasteve te veshtira.
- Shkembim eksperience te mjekeve shqiptare jashte shtetit ne rastin e trajtimit te femijeve te semure kardiak jashte shtetit.
- Mundesi per pajisjen e Spitaleve tona me aparatura e pajisje nga bashkepunimi me mjeket e huaj.
- Promovim per kontributet e mjekeve shqiptare e te huaj ne trajtimin e femijeve te semure kardiak.
- Botime per sensibilizimin e trajtimin e femijeve te semure kardiak.
- Rotary Club Tirana West angazhohet me palet ne Marreveshje dhe ne kuadrin e BKRSH (Bordi i Klubeve Rotariane te Shqiperise) ne realizimin e kesaj Marreveshje.
- BKRSH (Bordi i Klubeve Rotariane te Shqiperise) angazhohet te asistojte prane Rotary International ne realizimin e kesaj Marreveshje, per ta perfshire ne Programet e TRF (The Rotary Foundation), si Projekt i rendesishem ne kuadrin BKRSH (Bordit te Klubeve Rotariane te Shqiperise).

Skender Garori, Kryetar i BKRSH
(Bordi Kl. Rotary te Shqiperise)

Enver Doda, President - RCTW



Ogerta Manastirliu
Drejtoresha e OBIT

Governor, District 7490-IUSA

OFL Rotary Club - USA

JOSEPH LAUREN
CHAIRMAN

GIFT OF LIFE FOUNDATION
ROTARY DISTRICT 7490

dt. 28.06.2014
A.B. Doda